



Republika e Kosovës  
Republic of Kosova



100 Vjet Shtet Shqiptar



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr. 7813 /2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.1 , 40 (të shpallur në Gazetën Zyrtare nr.28/2008), Ligjin për Financat e Pushtetit Lokale, nr.03/L-049 neni 2.3, Statutin e komunës së Hanit të Elezit neni 56. kërkesës së Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve 02.nr.7813/2012, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 22.11.2012 mori:

## V E N D I M PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

### I

Miratohet Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për familjet e dëshmorëve në komunën e Hanit të Elezit për heqjen e shpenzimeve dhe dërgimin e tyre në Banjë të Klllokotit.

### II

Shuma e mjeteve që do të ndahen për nga një anëtar të familjes është 220 € kurse shuma e përgjithshme është 2640 € për 12 anëtar të familjeve të dëshmorëve, ndërsa qëndrimi në banjë do të jetë 10 ( dhjetë ) ditorë.

### III

Mjetet financiare do të merren nga kategoria buxhetore mallra dhe shërbime.

### IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

### V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve dega Hani i Elezit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit  
Data: 26.11.2012

Kryesuesi i Kuvendit  
Menduh Vlashi

